

V E N D I M
Nr. 408, datë 31.8.1999

PËR PRIVATIZIMIN ME TENDER TË NDËRMARRJEVE SHTETËRORE

(Ndryshuar me VKM nr. 445, datë 17.8.2000; nr. 191, datë 6.4.2001)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin, mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” (ndryshuar me ligjin ligjin nr. 8159, datë 7.11.1996 dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 195, datë 20.3.1998 “Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen) me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Të përgjithshme

1. Privatizimi me tender i ndërmarrjeve bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave për privatizimin me tender të ndërmarrjeve, duhet të përcaktojë formën e tenderit të hapur ose të kufizuar, në rastin e tenderit të kufizuar edhe emrat e kandidatëve që ftohen për të marrë pjesë në tender.
3. Në rastin e tenderit të hapur të gjithë kandidatët e interesuar ftohen të paraqesin ofertat e tyre, ndërsa në tenderin e kufizuar, paraqesin ofertat vetëm kandidatët që ftohen direkt nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.
- Kandidatët që marrin pjesë në tender duhet të jenë persona juridikë, vendas apo të huaj.
4. Procedurat e tenderit realizohen nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.
5. Vlerësimi i objektit do të bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedura e shitjes”.

II. Procedurat

1. Në zbatim të vendimit të këshillit të Ministrave për privatizimin me tender të ndërmarrjes, Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nxjerr urdhrin për përgatitjen e dokumentacionit.

2. Dokumentacioni për privatizimin me tender përgatitet nga ndërmarrja, organi i varësisë administrative dhe dërgohet pranë Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Kjo e fundit pas shqyrtimit e dërgon në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit.

Agjencia Kombëtare e Privatizimit, brenda 5 ditëve nga mbërritja e dokumentacionit, shqyrton rregullsinë e tij dhe kur e gjen të rregullt fillon menjëherë procedurat e publikimit. Kur në dokumentacionin e dërguar vërehen parregullsi të kërkesave të kapitullit II.1, Agjencia Kombëtare e Privatizimit kërkon plotësimin e tij nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

3. Agjencia Kombëtare e Privatizimit do të garantojë barazinë e informacionit për të gjithë kandidatët e interesuar, si dhe do të sigurojë informacionin e nevojshëm për ta.

4. Dorëzimi dhe hapja e ofertave bëhet para Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.1. Ftesa për tender dhe njoftimi i tij

1. *Ftesa për tender publikohet në tri gazeta me qarkullim kombëtar, jo më pak se tri herë në secilën gazetë, brenda një afati 30 ditor. Gjatë kësaj periudhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit vendos afishe të ftesës për tender pranë vendndodhjes së ndërmarrjes. Vendi, mënyra dhe data e saktë e dorëzimit të ofertave caktohet brenda një afati jo më pak se 15 ditë nga data e fundit e publikimit të ftesës për tender.*

2. Ftesa për tender do të përmbajë:

- a) Emërtimin e objektit dhe vendndodhejn e tij.
- b) Formën e tenderit.
- c) Vendin dhe afatin për tërheqjen e dokumentacionit të tenderit
- d) Pagesën për tërheqjen e materialit informativ, në këmbim të një deklaratë me shkrim për ruajtjen e konfidencialitetit për dokumentacionin e tërhequr nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.
- e) Vendin, mënyrën dhe datën e saktë për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.
- f) Specifikime për garancinë e tenderit dhe përcaktimi i afatit përfundimtar të vlefshmërisë së ofertës.

Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit do të paraqesë tek Agjencia Kombëtare e Privatizimit, në origjinal ose të njësuar me të, sipas formës së kërkuar nga ligji, dokumentacionin që vijon:

- a) Vendimin e Këshillit të Ministrave për privatizimin me tender të objektit.
- b) Bilancet për 3 vjetët e fundit të aktivitetit.
- c) Vlehtë e objektit që ofrohet në tender.
- d) Genplanin, planimetria dhe aktivlerësimi i truallit të objektit.

Material informativ ose material përmbledhës me të dhëna kryesore të objektit që privatizohet:

Përshkrimin e objektit:

- emrin
- datën e krijimit
- sferën e aktivitetit
- kohën e veprimtarisë
- raportet e treguesve të fundit vjetorë të ndërmarrjes shtetërore (si bilanci, deklarata e të ardhurave etj.)
- paraqitja e detyrimeve tatimore nga autoritetet kompetente.

3. Brenda afatit të caktuar në ftesën e tenderit, kandidatët e interesuar, përkundrejt pagesës, mund të tërheqin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Planimetrinë dhe genplanin e objektit të publikuar.
- b) Afatet dhe kushtet e shitjes, duke përfshirë aplikimin e metodave të pagesës dhe një sistem të mundshëm të kërkesave lidhur me politikën e biznesit, politikën e punësimit dhe të zhvillimit, kushtet për mbrojtjen e mjedisit etj. dhe garancitë e nevojshme dhe sanksionet në lidhje me detyrimet.
- c) Vendi ku drejtohen pyetjet në lidhje me tenderin dhe mundësinë për sigurimin e informacionit shtesë.
- d) Specifikime për garancinë e tenderit dhe përcaktimi i afatit përfundimtar të vlefshmërisë së ofertës.
- e) Bilancet për 3 vjetët e fundit të aktivitetit të ndërmarrjes shtetërore.
- f) Vlehtë e objektit.
- g) Material informativ përmbledhës me të dhëna kryesore të ndërmarrjes shtetërore që privatizohet.
- h) Procedura e vlerësimit të dokumentacionit dhe kriteret përkatëse, me konsiderata të veçantë për sa më poshtë:
 - koha dhe vendi i hapjes së ofertave;
 - përcaktimi i kohës për vlerësimin e ofertave;
 - mënyra dhe vendi i shpalljes së rezultateve të tenderit.
- i)Lista e përmbajtjes së ftesës për tender dhe anekset e saj.

III. Garantimi i tenderit

1.Çdo kandidat për pjesëmarrjen në një tender duhet të paraqesë:

- a) Dokumentin bankar që vërteton ngrirjen për periudhën deri në përfundim të tenderit,

të pagesës paraprake në lekë apo garanci bankare me 30 për qind të vlerës së objektit që ofrohet për tender, në datën dhe mënyrën e specifikuar në ftesën për tender. Kjo shumë ngrihet për llogari të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

b) Vendimin e regjistrimit në gjykatë, dokumente referencash nga institucione bankare dhe financiare.

2. Kushti i garancisë së tenderit do të kthehet në rast se:

-Ftesa për tender është anuluar;

-Dokumentet e paraqitura për ofertë janë të pavlefshme;

-Pjesëmarrësi nuk është fitues i tenderit;

- Kontrata nuk është e përfunduar për shkaqe për të cilat Agjencia Kombëtare e Privatizimit është përgjegjëse.

3. Kushti i garancisë së tenderit nuk do të kthehet në rast se:

-Në pajtim me ftesën për tender ajo është transformuar në një siguri suplementare për garantimin e përfundimit të kontratës;

-Anulohet nga kandidatët oferta e tyre gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave;

-Kandidati është gjetur përgjegjës për moslidhjen e kontratës;

-Kontrata nuk është përfunduar për çdo arsye që bie ndesh me interesat e kandidatëve të tjerë pjesëmarrës në tender.

4. Me kërkesën e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, kandidati është i detyruar të paraqesë dokumentacionin përkatës për të vërtetuar cilësitë e tij të vendosura në ofertë.

IV. Paraqitja dhe vlefshmëria e ofertave

1. Në ditën dhe vendin e përcaktuar në ftesën për tender kandidatët do të paraqesin ofertat e tyre (në 5 kopje) në zarf të mbyllur, të vulosur, pa emrin e kandidatit. Çdo faqe e 5 kopjeve të ofertës duhet të jetë me firmën origjinale të kandidatit (ose të autorizuarit prej tij).

2. Kandidati do të paraqesë vetëm një ofertë.

3. Ofertat e paraqitura në përgjigje të një ftese për tender do të përmbajnë deklaratën me anë të së cilës kandidati angazhohet për:

-pranimin e kushteve të përcaktuara në ftesën për tender;

-marrjen përsipër të detyrimeve dhe shërbimeve që rrjedhin nga kjo;

-shumën për çmimin e ofruar ose alternativat e tij.

4. Ditën e dorëzimit dhe hapjes të ofertave vlerësohet qenia e tyre konform kërkesave të këtij vendimi dhe mbi këtë bazë vendoset për ofertat që janë të vlefshme për të vazhduar procedurën.

5. Pavarësisht nga vlefshmëria e ofertave, sukcesi ose dështimi i tenderit, shpenzimet për përgatitjen e ofertave dhe për përfshirjen e kandidatit në tender do të përballohen nga vetë kandidati.

V. Konfidencialiteti

1. Deri në përfundimin e kontratës së shitjes kandidati do të trajtojë konfidenciale përmbajtjen e ofertave, sikurse edhe të gjitha faktet, informacionin dhe të dhënat e vëna në dispozicion të tij nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit në materialin informativ të detajuar ose nëpërmjet çdo kanali tjetër konfidencial. Ai nuk do t'i japë informacion një pale të tretë. Kjo nuk zbatohet lidhur me faktet e komunikuara bankave dhe, në rastin e një oferte të përbashkët, për anëtarët e konsorciumit.

Në rastin e një tenderi të hapur nuk ruhet konfidencialiteti për të dhënat e vëna në dispozicion nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, për ndërmarrjen.

2. Agjencia Kombëtare e Privatizimit ka të drejtë të quajë ofertën e kandidatit përkatës të pavlefshme dhe ta anulojë atë, në qoftë se kandidati ose ndonjë person tjetër përfaqësues i tij dhunon konfidencialitetin lidhur me tenderin.

3. Agjencia Kombëtare e Privatizimit do të ruajë konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertave deri në përfundimin e tenderit dhe nuk do të japë asnjë informacion lidhur me

përmbajtjen e tyre.

4. Agjencia Kombëtare e Privatizimit do t'i përdorë ofertat vetëm për vlerësim. Nëse ato do të duhet të përdoren për qëllim tjetër, të dy palët duhet të bëjnë një kontratë të veçantë.

VI. Dorëzimi dhe hapja e ofertave

1. *Shfuqizuar.*

2. Ofertat dorëzohen dhe hapen në vendin dhe kohën e përcaktuar në ftesën për tender para komisionit të vlerësimit të ofertave.

VII. Detyrat e komisionit të vlerësimit të ofertave

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave krijohet 24 orë para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga këta anëtarë:

a) Përfaqësues i AKP

b) 2 përfaqësues të MEPP

c) 2 përfaqësues të organit të varësisë administrative

d) Juristi i AKP

e) Sekretar (punonjës i AKP).

Kryetar i komisionit të vlerësimit të ofertave është përfaqësues i AKP.

3. *Komisioni i vlerësimit të ofertave shpërblehen nga 2 deri 5 paga mujore të anëtarit, në varësi të rezultateve të tenderit, sipas përcaktimit të drejtorit të Agjensisë Kombëtare të Privatizimit. Ky komision nuk shpërblehet kur tenderi dështon. Shpërblimi mbulohet nga pjesa e të ardhurave të Agjensisë Kombëtare të Privatizimit prej procesit të Privatizimit.*

4. Nuk duhet të marrin pjesë në komisionin e vlerësimit të ofertave:

a) një person, i cili është kandidat në tender apo vetë kandidatët;

b) pronar (pronar i pjesshëm) ose anëtar i një ndërmarrjeje apo biznesi ligjor që paraqitet si kandidat.

5. Çdo person, pjesëmarrës në komisionin e vlerësimit të ofertave duhet të japë deklaratë për papajtueshmëri me sa është përcaktuar në pikën 2.

Rregullat e pikës 2 duhet të zbatohen, gjithashtu, në qoftë se për çfarëdo arsye të paragjykuar, gjykimi i çështjes nuk do të pranohej nga ndonjë prej kandidatëve në procedurën e vlerësimit të ofertës.

Këto dispozita duhet të aplikohen në mënyrë të vlerësueshme dhe transparente për të gjithë personat pjesëmarrës në vlerësimin e ofertës.

6. Antarët e komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të ruajnë konfidencialitetin. Kandidatët duhet të përdorin informacionin e kërkuar në cilësinë dhe të drejtën e mësipërme ekskluzivisht për qëllim të vlerësimit të ofertave.

7. Agjencia Kombëtare e Privatizimit, 2 (dy) ditë para dorëzimit dhe hapjes së ofertave i kërkon MEPP dhe organit të varësisë administrative emrat e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave.

VIII. Vlerësimi i ofertave

1. Njëkohësisht me dorëzimin dhe hapjen e ofertave, komisioni i vlerësimit të ofertave mund të kërkojë informacion nga kandidatët në tender, me qëllim lehtësimin e vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave. Pyetjet, si dhe përgjigjet e dhëna nga kandidatët në tender që lidhen me to, duhen të mbahen të regjistruara me shkrim. Kjo nuk do të ndikojë në ndryshimin e kushteve të kërkesës së dorëzuar për tender, por vetëm kryesisht në interpretimin e tyre.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave bën vlerësimin e ofertave mbi bazën e përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave. Vlerësimi bëhet sipas këtij mekanizmi:

Kandidati që, për një kriter të caktuar, jep shifrën më të mirë, do të marrë maksimumin e pikëve, ndërsa për të tjerët llogaritja do të bëhet mbi bazën e metodës proporcionale.

Pas llogaritjes së pikave, për secilin kandidat, bëhet renditja e tyre në mënyrë zbritëse, duke përcaktuar kandidatin më të mirë (atë që vlerësohet me numrin më të madh të pikëve).

3. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka këto detyra:

3.1. Të krahasojë ofertat në bazë të kriterëve dhe rëndësisë të specifikuara në ftesën për tender duke marrë në konsideratë dispozitat e këtij vendimi. Komisioni i vlerësimit mund të kërkojë pjesëmarrjen e një eksperti për dhënin e një vlerësimi, me qëllim për të vendosur për përfundime të veçanta.

3.2. Pas vlerësimit të secilës ofertë, komisioni i vlerësimit të ofertave harton një dokument argumentues për vlerësimin e bërë për ofertat. Ky dokument përmban:

- a) objektin e tenderit, vlerën e ndërmarrjes që nxirret për shitje;
- b) një përmbledhje të shkurtër të procedurës, numrin e ofertave të marra;
- c) një përmbledhje të ofertave të marra;
- d) kriterin kryesor të vlerësimit të ofertave dhe opinionin që çfaqet në lidhje me ofertat individuale;
- e) kriteret e përcaktimit të çmimit të blerjes;
- f) një vlerësim përmbledhës të rezultatit të procedurës së tenderit, së bashku me renditjen e kandidatëve sipas vlerësimit të bërë për ofertat e tyre.

IX. Deklarimi i pavlefshmërisë së ofertës dhe suksesit të tenderit

1. Një ofertë duhet të deklarohet e pavlefshme, në qoftë se:

- a) kandidati në tender nuk ka plotësuar garancitë e nevojshme;
- b) kandidati në tender ka shkelur konfidencialitetin e tenderit;
- c) kandidati në tender ka dështuar kur bën një deklaratë detajuese të legalizuar të ofertës së tij që nuk përputhet me ofertën e paraqitur;
- d) kur kandidati në tender nuk ka plotësuar kushtet e ftesës për tender.

1.1. Për rastet kur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendos për pavlefshmërinë e të gjitha ofertave të paraqitura, Agjencia Kombëtare e Privatizimit shpall një datë të re për paraqitjen e ofertave, në një afat jo më pak se 10 ditë, nga data e shpalljes së vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Njoftimi të përmbajë:

- *Vendin, mënyrën, datën dhe orën e saktë për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.*
- *Njoftimin se kushtet e ftesës për tender, të publikuara në raundin e parë, nuk kanë ndryshuar.*

- Shkaqet e njoftimit të datës së re për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.

2. Tenderi deklarohet i pasuksesshëm, në qoftë se:

- asnjë nga ofertat e marra në dorëzim nuk plotëson kërkesat e ftesës për tender;
- kërkesa të tjera përputhen me objektin e tenderit;
- Këshilli i Ministrave nuk miraton privatizimin e ndërmarrjes shtetërore.

2.1. Për rastet e mospjesëmarrjes së tenderit procedurat fillojnë nga kapitulli I.

X. Marrja e vendimit dhe njoftimi i rezultatit të tenderit

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka autoritetin e vlerësimit të ofertave dhe nxjerrjes së rezultateve të tenderit.

2. Nëse nuk është përcaktuar ndryshe në ftesën për tender, ofertat duhen vlerësuar brenda 10 ditëve nga afati i dorëzimit dhe hapjes së ofertave. Komisioni i vlerësimit të ofertave mund të zgjatë afatin përfundimtar për vlerësimin e ofertës në një rast, nëpërmjet një deklarimi të hapur, më e shumta edhe 5 ditë të tjera. Kjo u bëhet e njohur pjesëmarrësve në tender.

3. Në vendimin e rezultatit të tenderit duhen shënuar, me përjashtim të fituesit, edhe kandidatët e klasifikuar me tender në vend të dytë e të tretë, me të cilët AKP mund dhe duhet të përfundojë një kontratë, në rast se kontrata me fituesin dështon apo në qoftë se fituesi nuk plotëson kontratën.

4. *Shfuqizuar.*

5. AKP pas përfundimit të tenderit dhe nxjerrjes së rezultateve, brenda 7 ditëve, përgatit projektvendimin dhe relacionin përkatës dhe e dërgon në Këshillin e Ministrave.

XI. Mbyllja e kontratës.

1. *Vetëm pasi Këshilli i Ministrave vendos për miratimin e procedurave të privatizimit dhe shpall fituesin e tenderit, Agjensia Kombëtare e Privatizimit fillon negociimet dhe lidh kontratën e shitjes.*

2. *Elemente të kontratës për shitjen e pronës do të jenë të gjitha kërkesat e vendosura në ftesën për tender dhe penalitetet përkatëse.*

Procedurat e dorëzimit kryhen në mbështetje të kapitullit IV, të vendimit nr.192, datë 20.3.1998, të Këshillit të Ministrave. Afati për kryerjen e këtyre procedurave fillon nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për shpalljen e fituesit të tenderit.

3. *Kontrata duhet përfunduar brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave.*

Ngarkohet Agjensia Kombëtare e Privatizimit për ndekjen, zbatimin dhe plotësimin e kushteve të kontratës për një periudhë trevjeçare, sipas kriterëve të vendosura në ftesën për tender dhe treguesve të parqitur në ofertë.

4. Nëse kontrata:

a) dështon së qeni e zbatueshme ose,

b) pas nënshkrimit të kontratës fituesi dështon në plotësimin e saj dhe për këto arsye AKP i jep fund kontratës ose,

c) në qoftë se, palët bien dakord t'i japin fund kontratës, atëherë AKP, në këto raste, duhet të përdundojë një kontratë me ofruesin tjetër sipas radhës.

e) *Agjensia Kombëtare e Privatizimit negocion për nënshkrimin e kontratës me kandidatin e radhës, vetëm pas miratimit me vendim të Këshillit të Ministrave.*

5. *Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjensia Kombëtare e Privatizimit për nxjerrjen e udhëzimit në zbatim të këtij vendimi.*

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko